

## **Titulli i projektit: FMN - Reformat Fiskale në Evropën Juglindore - Faza III (nën-Kapitulli Administrimi i të Ardhurave)**

### **Afati kohor i projektit: 2023-2026.**

Ky projekt synon të ndërtojë më tej kapacitetet njerëzore dhe institucionale të nevojshme për:

- Adresimin e angazhimeve për konsolidimin fiskal.
- Menaxhimin e pasigurive dhe përgjigjet e politikave.
- Mbështet rimëkëmbjen pas pandemisë dhe rritjen e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

### **Rezultatet e pritura:**

- Forcimi i menaxhimit dhe qeverisjes së Administratës së të Ardhurave.
- Fuqizimi i funksioneve bazë të administratës tatimore.

### **Komponentët dhe objektivat përkatës:**

- Menaxhimi i riskut - Identifikimi, vlerësimi, renditja dhe sasia e risqeve të përputhshmërisë dhe zbutja e tyre gradualisht u përmirësua përmes zbatimit të një CIP që plotëson praktikatat e mira ndërkombëtare bazuar në pikët e TADAT POA.
- Rregullimi organizativ - Ndarja e qartë e roleve dhe përgjegjësiive zbatohet në të gjithë organizatën. Përmirësimet e pajtueshmërisë arrihen përmes modernizimit të kornizës operacionale.
- Pagesa e taksave - Pagesat në kohë të taksave janë përmirësuar gradualisht për të përmbushur praktikatat e mira ndërkombëtare bazuar në pikët e TADAT POA. Niveli i borxhit të arkëtueshëm reduktohet në maksimum dhjetë për qind të të ardhurave totale.
- Auditimi - Zbatohet verifikimi i automatizuar i të gjitha deklaratave tatimore përmes kryqëzimit me të dhënat përkatëse të brendshme dhe të palëve të treta. Monitorimi i zbatuar i boshllëqeve tatimore në të paktën një nivel të shëndetshëm të performancës, në përputhje me standardet TADAT.

### **Rezultatet e arritura dhe ndikimi:**

- Pajtueshmëria me propozimet e projektimit iu dorëzuan MFE- së;
- Është përgatitur dhe miratuar plani vjetor i përmirësimit të pajtueshmërisë për vitin 2025;
- Është hartuar dhe në funksion struktura e qartë organizative përgjatë linjave funksionale dhe/ose segmenteve të tatimpaguesve;
- Është miratuar një ndarje e qartë e roleve dhe përgjegjësiive ndërmjet AT (përkufizimi i procedurave standarde të funksionimit, planifikimi dhe monitorimi) dhe degëve rajonale (ekzekutimi).

Kapaciteti Strategjik Institucional në DPT është përmirësuar në një nivel të lartë dhe ka rezultuar në finalizimin e strategjisë së rekomanduar. Strategjia afatmesme e të ardhurave (MTRS), e miratuar në dhjetor 2024, përcakton një plan për të rritur të ardhurat me 2.5% të

PBB-së deri në vitin 2027, kryesisht përmes përmirësimit të administrimit të të ardhurave. Zbatimi i Planit Strategjik po përparon; megjithatë, presionet e konsiderueshme mbi kapacitetet kërkojnë monitorim të ngushtë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

**Të ardhurat për vitin 2025 janë 12% më të larta krahasuar me vitin e kaluar, në përputhje me MTRS.**<sup>1</sup> Progresi në përmirësimin e efikasitetit të mbledhjes së taksave përmes pajtueshmërisë vullnetare është në rrugën e duhur. Shërbimet e përmirësuara të tatimpaguesve – si njoftimet e reja për TVSH-në, nismat e digjitalizimit dhe anketimi i tatimpaguesve—kanë rritur nivelin e kënaqësisë. Komunikimi për përmbushjen tatimore është përqendruar në adresimin e informalitetit, veçanërisht në fushën e pagave, duke avancuar njëkohësisht strategjinë për individët me pasuri të lartë (HWI). Në sektorin e turizmit janë zbatuar kontrolle dhe sanksione të targetuara, në vend të inspektimeve masive me shtrirje të gjerë.

Një mision hibrid i administrimit të të ardhurave të Departamentit të Çështjeve Fiskale të FMN-së (FAD) u krye nga 13-20 janar 2026 me fokus *“Action Plan of the strategy dhe progress Review-Pagesat e taksave, për afrimi me praktikën e mira ndërkombëtare”*, i cili shërbeu për të shqyrtuar progresin e reformave në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) të Shqipërisë dhe – me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm – për të ofruar udhëzime për për afrimin e axhendës së pagesave në kohë / menaxhimit të detyrimeve të prapambetura me praktikën e mira ndërkombëtare.

*Rishikimi bazohet në:*

- (i) vlerësimin gjashtëmuor të Planit Strategjik të Administratës Tatimore 2024–2028,
- (ii) angazhimin paraprak të FAD dhe (iii) statusin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme dhe rezultateve të projektit nën programin e Fazës III të BE/SECO (2023–2026).

Shqipëria është Anëtar aktiv i të gjitha Komuniteteve të Praktikës së SEE-së, dhe për këtë cdo vit ka marrë pjesë në takimet rajonale për Kontrollin tatimor, Menaxhimin e Borxhit dhe për Menaxhimin e Riskut *Compliance Risk management CoP*.

Takimi i 3-të për *“Vetë-vlerësimin në zbatimin e strategjisë së re MTRS dhe Administrimit të të Ardhurave (EU/SECO self-assessment of log frame progress)* u zhvillua në Tetor 2025. *Accelerating institutional capacity progress in 2025 for all four outcomes in the EU/SECO financed Phase III project*” *“Përshpejtimi i progresit të kapaciteteve institucionale në vitin 2025 për Fazën e III të Projektit, financuar nga BE/SECO.*

---

<sup>1</sup> Prezantimi i DPT në MPB janar 2026: ADMINISTRIM I MIRË TATIMOR Arritjet në vitin 2025 dhe sfidat në 2026